

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E  
REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE  
2015 – 2020**

**Raporti Vjetor i Monitorimit  
2015**

Tirane, Shkurt 2016

## Pasqyra e Lëndës

|  |    |
|--|----|
| <i>I. Përmbledhje Ekzekutive</i> .....                                       | 3  |
| 1. Hyrje.....  | 6  |
| 2. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë.....                  | 8  |
| 3. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit Prioritet.....      | 8  |
| 3.1.1. Prioriteti I: Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit.....         | 8  |
| 3.1.2. Prioriteti 2: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike..... | 17 |
| 3.1.3. Prioriteti III Shërbimi civil: Menaxhimi i burimeve njerëzore.....    | 20 |
| 3.1.4. Prioriteti IV - Procedurat administrative dhe mbikëqyrja.....         | 25 |
| 4. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2016.....                   | 34 |

## Article I. *Përmbledhje Ekzekutive*

Raporti i progresit vjetor i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020 ka për qëllim analizën dhe vlerësimin e përgjithshëm të ecurisë së zbatimit të kësaj strategjie bazuar në katër prioritetet kryesore dhe objektivave respektivë për vitin 2015.

Gjetjet e këtij raporti janë inkurajuese. Për këtë periudhë të shkurtër 8 mujore, **deri në fund të dhjetorit 2015, 63% e aktiviteteve të parashikuara në Strategji kanë filluar të zbatohen, ndërsa 6 prej tyre janë realizuar plotësisht.**

**Qeveria Shqiptare ka realizuar një progres të konsiderueshëm në prioritetin e katërt mbi “Procedurat administrative dhe mbikëqyrjen”.** Fokusi kryesor i përpjekjeve të qeverisë për këtë prioritet ka qenë mbështetja e veprimtarisë së përditshme të administratës publike dhe rritja e efikasitetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve për zhvillimi i një infrastrukture të Teknologjisë së Informacionit (TIK)..

Qeveria aktualisht ka në funksionim dy sisteme elektronike monitorimi, të cilat monitorojnë shkallën e realizimit të planeve operacionale të punës nga ana e ministrive të linjës si dhe procesin i hartimit të legjislacionit si dhe konsultimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2015 është punuar për zhvillimin e tre sistemeve të tjera monitorimi, të cilat janë EDRMMS - Sistemi i Menaxhimit dhe Monitorimit të Korrespondencës Shkresore, Sistemi i monitorimit të shkallës së realizimit të angazhimeve të programit të Qeverisë, si dhe sistemi i integruar i monitorimit të menaxhimit të cilësisë. Progresi i bërë në këtë kuadër tregon vizion të qartë për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit dhe monitorimit të punës brenda Qeverisë Shqiptare.

Zhvillimi i infrastruktures TIK vjen gjithashtu në ndihmë të qytetarëve nëpërmjet krijimit të një mekanizmi inovativ që siguron përfshirjen direkte të qytetarëve në monitorimin e cilësisë së shërbimit. Ky sistem monitorimi është zbatuar gjatë vitit në ZRPP Tiranë, Durrës dhe Vlorë dhe në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë.

**Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë gjithashtu në drejtim të realizimit të proceseve përgatitore për thjeshtëzimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve publike.** Gjatë vitit 2015 ka përfunduar kodimi i të gjitha shërbimeve në inventarin e shërbimeve administrative qendrore, sipas një metodologjie të bazuar në praktikën më të mirë të BE, si dhe është miratuar ligji “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” i cili do

të ndikojë mbi të gjithë institucionet e administratës publike me synimin e unifikimit të të gjithë sistemit të ofrimit të shërbimeve.

**Në maj të vitit 2015 u ri-dizenjua plotësisht portalin unik qeveritar e-Albania.** Portal i cili vjen në formë më të thjeshtë, më të lehtë dhe më praktike gjithashtu i përshtatur edhe për celularë, ku qytetarët shqiptarë, bizneset dhe zyrtarët publik aktualisht përfitojnë mbi 765 shërbime elektronike. Portali i ri, ofron për herë të parë shërbimin e pagesave on-line.

Në fushat e tjera prioritare vlen të përmendet progresi i deritanishëm në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të prioritetit të “Sistemit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit” dhe prioritetit të “Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

**Gjatë vitit 2015 vazhdoi me sukses hartimi i disa dokumentave strategjikë.** Në 2015 përfundoi hartimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim II (SKZHI) si dhe u hartuan 7 strategji sektoriale kombëtare, duke e çuar në 22 numrin e strategjive të miratuara nga 29 strategji sektoriale që duhet të hartohen si pjesë e kuadrit strategjik të SHKZHI.

**Është arritur progres i konsiderueshëm në plotësimin e mekanizmave ligjorë dhe insitucionalë që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike.** Ka filluar zbatimi i Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Këshilli i Ministrave ka aprovuar tashmë kuadrin ligjor për ngritjen e regjistrat elektronik “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në zbatim të këtij ligji 7 strategjitë e miratuara gjatë vitit 2015 kaluan në një proces të gjerë konsultimi publik. Brenda periudhës korrik – dhjetor 2015, 97% e akteve të miratuara, që duhet të kalonin procedurat e konsultimit publik e kanë realizuar këtë proces.

Në kuadër të prioritetit të dytë të organizimit dhe funksionimit të Administratës Publike është punuar në dy aspekte kryesore : për fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut dhe ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcuar etikën në ofrimin e shërbimeve publike.

**Gjatë vitit 2015 ka vijuar puna për të analizuar përshkrimet e punës për secilin pozicion në shërbimin civil, pjesë e administratës shtetërore.** Hartimi i përshkrimeve të punës, të mirëshkruara dhe të standardizuara për çdo grup pozicionesh, pjesë e shërbimit civil është element thelbësor në synimin e fuqizimit të strukturave të administratës publike.

Si pjesë e reformës territoriale dhe fuqizimit të bashkive të reja, **fokusi ka qënë gjithashtu të sigurohet mbështetja metodologjike për organizimin dhe funksionimin e njësive të reja administrative të vendit dhe forcim të kapaciteteve zbatuese.** Deri në 31 dhjetor 2015 janë hartuar 5 modele tip organizimi të bashkive.

**Në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike është pilotuar ndarja e Sporteve të Shërbimit dhe Zyrave Përgjegjëse për Shërbimin,** e Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë duke ndryshuar mënyrën e organizimit të punës, vendosur

standarde të reja në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuar përvojën e qytetarëve në marrëdhëniet me këtë institucion. Në kuadër të procesit të Krijimit të Sporteve Unike për shërbimet administrative në nivel vendor, ka filluar pilotimi i sporteve unike në bashkitë Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.

**Progres është arritur në drejtim të forcimit të paanshmërisë dhe garantimit të një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm dhe meritokratik dhe rritjen e integritetit të nënpunësve civilë** nëpërmjet ndërtimit të Bankës së Pyetjeve, që do të përdoret në procesin e rekrutimit në shërbimin civil. Një arritje është shënuar edhe në Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit Informatik të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ) duke përfshirë tashmë elementë që sigurojnë menaxhimin dhe forcimin e kontrollit të pagave.

**Në kuadër të modernizimit të sistemit të trajnimit dhe rritjen e aksesit në kurrikulat e trajnimit janë zhvilluar platformat e – learning dhe e – training.** Këto platforma do të mundësojnë lehtësi në aksesin e materialeve të trajnimit on-line, mundësi përfitimi njohurish për një numër më të madh nënpunësish civil dhe punonjësve të tjerë të administratës publike.

SNRAP në vitin e parë është përballur edhe me disa sfida ku kryesorja është mungesa e burimeve të plota financiare për zbatimin e saj. Për këtë qëllim, me kërkesë të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administratës Publike u realizua rishikimi i planit financiar për zbatimin e strategjisë me qëllim evidentimin e hendekut financiar të Strategjise dhe reduktimit të kostos të disa aktiviteteve. Pritet adresimi i kësaj çështje sa më parë gjatë vitit 2016.

Gjithashtu nuk kanë filluar ende aktivitet në lidhje me ngritjen e kapaciteteve në kuadër të përdorimit sistematik të vlerësimit të hapësirave korruptive të legjislacionit (corruption proofing). Ndërsa edhe pse është bërë progres lidhur me publikimin e programeve të transparencës me publikun, ky proces mbetet ende në nivele të ulëta, në nivel të administratës publike.

Gjithashtu zbatimi i ligjit "Për nëpunësin civil" haset ende me disa probleme, të cilat qeveria po mundohet ti adresojë nëpërmjet masave që po merr në drejtim të forcimit të kontrollit dhe zbatimit të sistemeve të reja të menaxhimit të tij.

## Article II. Hyrje

Reforma në administratën publike në Shqipëri është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me procesin e integritimit në Bashkimin Europian (BE). Ajo mbetet një ndër prioritetet e Qeverisë si një instrument kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit dhe si kusht për proceset integruese të vendit.

Marrja e statusit të vendit kandidat në 24 qershor 2014, shënon një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integritimit evropian, proces i cili kërkon një administratë profesionale dhe kapacitete njerëzore e materiale për të mundësuar jetësimin e politikave dhe objektivave kombëtare, të ndërmarra në kuadër të përmbushjes së detyrimeve në këtë drejtim.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në prill 2015, ofron kornizën e përgjithshme për reformën e Administratës Publike Shqiptare për periudhën 2015-2020 dhe shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës dhe përmbushjen e detyrimeve për integrimin në BE.

Vizioni që udhëheq Strategjinë është:

***“Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, të efektshme dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative që përputhet me kërkesat e integritimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.”***

Zbatimi i këtij vizioni mbështetet në reformat që do të ndërmerren në katër fusha kryesore prioritare që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të :

- Sistemit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit
- Mënyrës së organizimit të administratës publike:
- Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:
- Procedurave administrative dhe mbikëqyrjes:

Zbatimi i Strategjisë do të kryhet në dy faza:

**Në fazën e parë, e cila përkon me aktivitetet në planin e veprimit nga 2015 – 2017** (objektivat afatmesme), përpjekjet do të përqendrohen në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurave për hartimin dhe monitorimin politikave, strategjive, planeve operacionale të punës dhe legjislacionit, si dhe në rritjen e kapaciteteve të përfshira në këto procese. Po ashtu në fokus do të jetë reforma strukturore institucionale dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve e bizneseve nëpërmjet mjeteve TIK. Zbatimi i legjislacionit të ri të shërbimit civil dhe rritja e kapaciteteve institucionale përgjegjëse për zbatimin e tij, përfundimi dhe bërja tërësisht funksionale e

databazës elektronike të burimeve njerëzore në administratën publike, me qëllim përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të shërbimit civil me standardet evropiane.

**Faza e dytë përfshin periudhën 2018 - 2020** (objektivat afatgjata) dhe synon konsolidimin e arritjeve të realizuara në fazën e parë të zbatimit të strategjisë, duke përfshirë më tej aktivitete të reja në fushat kryesore të reformës administrative.

Zbatimi efikas dhe me sukses i Strategjisë do të sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategji. I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit udhëhiqet në nivel politik nga Ministri përgjegjës për Administratën Publike dhe Inovacionin, në bashkëpunim me Departamentin e Programimit, Zhvillimit dhe Ndhmës së Huaj. Grupi për Menaxhim dhe Integrim të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 129 datë 21.09.2015, do të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e Strategjisë për reformën në administratën publike.

Ky raport vjetor është raporti i parë i monitorimit të SNRAP 2015-2020.


### Article III. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë

Vlerësimi i progresit të bërë për arritjen e objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të treguesve të suksesit të parashikuar në dokumentin e Strategjisë. Ndërsa vlerësimi i ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë bazohet në vlerësimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2015 - 2017 (PVRAP).


PVRAP 2015 – 2017 përfshin në total 53 aktivitete bazë dhe 83 nën-aktivitete që duhet të zbatohen gjatë tre viteve të para të zbatimit të Strategjisë. Për efekte të monitorimit 83 nën-aktivitetet janë konsideruar dhe referohen, më poshtë në raport, si aktivitete të veçanta.

Nga aktivitetet e zbatuara gjatë vitit 2015, 6 prej tyre janë realizuar plotësisht, ndërsa 44 aktivitete (89 % e aktiviteteve në zbatim, ose 51% e totalit të aktiviteteve ) janë realizuar pjesërisht.

Grafiku 1: Statusi i Përgjithshëm i Zbatimit të Aktiviteteve



Grafiku 2: Shkalla e Realizimit të Aktiviteteve



### Article IV. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit Prioritet

#### (a) Prioriteti I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

Prioritetet kryesore të reformave në fushën e politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit fokusohen në:


- *Përmirësimin e planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumente strategjike të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete*
- *Zbatimin e një sistemi transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me Acquis*




- *Ndërtimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: (i) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanes dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe (ii) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi i politikave.*

Siç paraqitet në grafikët 3 dhe 4 më poshtë, 19 nga 31 aktivitetet e parashikuara kanë filluar të zbatohen në vitin 2015, ndërsa dy aktivitete janë realizuar në vitin 2015. Progres më i mirë vihet re lidhur me aktivitetet e planifikuara nën Objektivin 1, i cili ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve në zbatim.

Grafiku 3: Numri i aktiviteteve në zbatim



Grafiku 4: Statusi i realizimit të aktiviteteve



### Progresi kundrejt secilit objektiv

Nga 13 aktivitetet të parashikuara nën **Objektivin 1: “Përmirësimi i planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete”** pjesa më e madhe e tyre (9) kanë filluar tashmë zbatimin dhe 1 aktivitet u realizuar tërësisht në vitin 2015.

**Progres është arritur në drejtim të hartimit të kuadrit strategjik. U përfundua procesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim-II (SKZH)** e cila përbën një nga komponentët kyç të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI).

Finalizimi i dokumentit të strategjisë u parapri nga një proces i gjërë konsultimi publik me një numër të madh organizatash dhe institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare, përfshirë këtu 43 institucione qendrore dhe 24 institucione të pavarura, komunitetin e donatëve. Dokumenti i strategjisë është kryer nga Komiteti për Planifikimin Strategjik në shkurt 2016, dhe pritet të aprovohet në Qeveri sapo të përfundojë procesi i konsultimit publik me aktorë të tjerë dhe grupe të tjera të interesit.

**83% e kuadrit rregullator strategjik (strategjitë sektoriale nën SKZH) kanë arritur të hartohen e të vihen në zbatim deri në fund të vitit 2015.**

Gjatë vitit 2015 vazhdoi me sukses hartimi i strategjive ndërsektoriale. Kështu gjatë vitit 2015 janë hartuar **7 strategji sektoriale kombëtare**, duke e çuar në 22 numrin e strategjive të miratuara nga 29 strategji sektoriale që duhet të hartohen si pjesë e kuadrit strategjik të SKZHI.

Këto strategji janë:

1. Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit, 2015-2020<sup>1</sup>
2. Strategjia Ndërsektoriale Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020<sup>2</sup>
3. Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020<sup>3</sup>,
4. Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020<sup>4</sup>
5. Strategjia Kombëtare Sektoriale e Rendit Publik 2015-2020<sup>5</sup>
6. Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut 2020<sup>6</sup>
7. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale dhe Plani i Veprimit 2015-2020<sup>7</sup>

Një rëndësi e veçantë u kushtua, gjatë fazës së hartimit të strategjive të mësipërme, sigurimit të cilësisë së dokumentave të hartuara, me qëllim që ato të mbështeteshin jo vetëm në një kuadër monitorimit të qartë, (me plan veprimi dhe tregues monitorimi të mirëpërcaktuar), por edhe brenda një kuadri financiar të përballueshëm dhe të lidhur sa më ngushtë me burimet financiare dhe Programin Buxhetor Afatmesëm. Të pesë strategjitë e listuara më sipër përmbajnë si planet e veprimit, treguesit e monitorimit dhe janë plotësisht të kostuara për secilin aktivitet.

Treguesi **100% për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të përfunduara dhe me cilësi (me plan veprimi të kostuar dhe me set indikatorësh me synimet përkatëse)** është arritur në masën 70 % për grupin e strategjive sektoriale të aprovuara në vitin 2015.

Në vijim të **rritjes së shkallës së koordinimit të iniciativave publike dhe sigurimin e harmonizimit të ndërhyrjeve në sektorë të ndryshëm** në muajin shtator 2015 u miratua<sup>8</sup> ngritja e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave për katër sektorë: (i) Qeverisjen e Mirë dhe Administratën Publike; (ii) Menaxhimin e Integruar të Ujit; (iii) Konkureshmërinë dhe Inovacionin dhe (iv) Punësimin dhe Sektorin Social. Qëllimi kryesor i secilit GMIP është të udhëheqë dhe të koordinojë institucionet e përfshira në sektorët përkatës, duke përdorur një kuadër të bazuar mbi rezultatet, dhe të zhvillojë dhe zbatojë një Kuadër Sektorial Strategjik, që

<sup>1</sup> Miratuar me VKM nr.247, datë 20.03.2015, Flet.Zyrtare Nr.47, Faqe: 2016

<sup>2</sup> Miratuar me VKM nr. 284, datë 01.04.2015, Flet.Zyrtare Nr.56, Faqe:2441

<sup>3</sup> Miratuar me VKM nr.319, datë 15.04.2015, Flet.Zyrtare Nr.62, Faqe: 2739

<sup>4</sup> Miratuar me VKM Nr.691, datë 29.07.2015, Flet.Zyrtare Nr.147, Faqe:10887

<sup>5</sup> Miratuar me VKM Nr.702, datë 26.08.2015, Flet.Zyrtare Nr.155, Faqe:11141

<sup>6</sup> Miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015, Flet.Zyrtare Nr.157, Faqe:157

<sup>7</sup> Miratuar me VKM Nr. 1071, datë 23.12.2015, Flet.Zyrtare Nr. 239 , Faqe: 16304

<sup>8</sup> Miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr.129 Dt.21.09.2015

parashikon dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e reformave dhe programeve të parashikuara nga Qeveria.

Gjithashtu, po në kuadër të mirë-kordinimit të politikave dhe projekteve në sektorë të ndryshëm është përgatitur ***Paketa Unike Kombëtare e Projekteve*** me 39 projekte prioritare për sektorët transport, energji, mjedis, infrastrukturë sociale.

***Ka nisur procesi i ngritjes së një sistemi të integruar të informacionit lidhur me zhvillimin dhe monitorimin e politikave.*** Pas vlerësimit të nevojave në lidhje me planifikimin strategjik dhe planifikimin e politikave publike është përfunduar dhe miratuar dokumenti i dizenjimit të Sistemit të Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPSIS)<sup>9</sup>.

Kanë filluar procedurat e tenderimit për tu përfunduar si procedurë brenda vitit 2016 . Pas ngritjes së sistemit do të përgatiten modulet e trajnimit për t'u vënë në zbatim për trajnimin e stafeve në institucionet respektive.(2017)

Monitorimi i zbatimit të strategjive është një proces shumë i rëndësishëm i cili siguron jo vetëm rritjen e përgjegjshmërisë dhe forcimin e llogaridhënies lidhur me arritjen e masave dhe objektivave të caktuara në secilën strategji të aprovuar nga qeveria, por mbi të gjitha është edhe një proces që ndihmon vendimarrësit në pasqyrimin e qartë të ecurisë së zbatimit të reformave të ndryshme sektoriale, evidentimin në kohë të problematikave të ndryshme që mund të shoqërojnë procesin e zbatimit të strategjive.

Aktualisht ekziston një sistem i monitorimit të SKZHI-së, ndërkohë që po synohen në zhvillimin e një kuadri të ri metodologjik për monitorimin e strategjive, kuadër i cili do të shoqërohet edhe me ngritjen e kapaciteteve të ministrive të linjës për raportimin dhe monitorimin e strategjive të hartuara.

***Një rëndësi e veçantë i është kushtuar ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve për planifikimin strategjik.*** Janë hartuar kurrikulat por dhe janë zhvilluar 2 cikle/paketa trajnimesh nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) lidhur me hartimin e kuadrit strategjik dhe strategjive sektoriale/ndersektoriale (sipas metodologjisë ekzistuese). Gjatë këtyre trajnimeve janë trajnuar 30 nëpunës të shërbimit civil (NC), për kuadrin strategjik dhe 57 NC për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA-në), si edhe 150 NC për hartimin e Projekteve Unike Sektoriale.

***Kutia 1: Sistemi i Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar***

***Objektivi kryesor*** i IPSIS është të mbështesë zhvillimin e politikave, analizën, planifikimin, raportimin, monitorimin dhe vlerësimin në një proces konsultativ në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar.

***Prioritetet kryesore të IPSIS janë:*** (i) Baza e të dhënave për politikbërjen; (ii) Përmirësimi i mëtejshëm i lidhjes midis planifikimit strategjik të politikave dhe planifikimit të buxhetit, duke aplikuar drejt qasjes sektoriale dhe lidhjes me planifikimin buxhetor afatmesëm; (iii) Forcimi drejt orientimit të performancës dhe rezultateve të monitorimit në nivelet e SKZHI, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, programeve buxhetore - në mënyrë të veçantë duke mbështetur ministrinë e linjës në monitorime (PAM) dhe raportime lidhur me strategjitë sektoriale & ndërsektoriale.

***Sistemi IPSIS do të ofrojë funksionalitet kryesor:*** (i) Përgatitja e SKZHI, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale; (ii) Procesin e konsultimit ndër-institucional për planifikimin strategjik; (iii) Monitorimin e SKZHI, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale duke përdorur metodologjinë për monitorimi për Vlerësimin e Performancës (PAM) dhe (iv) Raportimi për nivele të ndryshme të përpunimit të të dhënave mbi arritjet dhe progresin.

<sup>9</sup> Information System for Integrated Planning System

Gjatë vitit 2015 u trajnuan 20% e stafëve politikëbërëse në ministritë e linjës për çështje të planifikimit strategjik.

**Qeveria Shqiptare që nga fillimi i mandatit deri në fund të vitit 2015 ka bërë një përparim të konsiderueshëm për përmirësimin e sistemit të planifikimit operacional të punës.** Hapat më të rëndësishëm që janë ndërmarrë deri në fund të vitit 2015 janë këto:

**Hartimi i planeve operacionale të punës nga të gjitha ministritë e linjës:** Plani operacional i punës është një dokument teknik planifikimi i cili pasqyron çdo veprimtari që zhvillon ministria gjatë një intervali të caktuar kohor. Ky dokument nuk ka qenë më parë pjesë e dokumentave të planifikimit, duke përberë një hallkë të munguar<sup>10</sup> në ciklin e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të punës së Qeverisë. Hartimi i planeve operacionale të punës e plotësoi këtë mangësi të sistemit duke bërë të mundur që çdo ministri të ketë një dokument gjithëpërfshirës, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe realizimin e funksionit menaxhues dhe monitorues në mënyrë efektive dhe eficiente.

**Zbatimi i integruar i kuadrit logjik gjatë planifikimit operacional të punës:** Hartimi i planeve operacionale të punës u shoqërua me zbatimin për herë të parë në shkallë të gjerë dhe në mënyrë të integruar në të gjitha ministritë e linjës të kuadrit logjik të planifikimit.

**Vënia në funksionim e “Sistemit Elektronik të Menaxhimit dhe Monitorimit të Planeve Operacionale të Punës”.** Ky sistem është një platformë elektronike e mbështetur mbi programin Microsoft Project Management dhe e zhvilluar më tej për të mundësuar menaxhimin dhe monitorimin e planeve operacionale të punës. Ky sistem mundëson monitorim në kohë reale të shkallës së realizimit të planeve operacionale të punës nga gjithë strukturat e përfshira, ministri dhe Zyra e Kryeministrit. Sistemi aktualisht është në rrugën e hapjes për të lehtësuar aksesin me të lartë nga administrata me qëllim përdorimin e tij në mënyrë efektive në drejtim të menaxhimit dhe monitorimit të veprimtarisë së saj.

Zbatimi në të gjitha ministritë e linjës e një matrice planifikimi që siguron koordinim të planit operacional të punës me dokumente të tjera të planifikimit. Për të mundësuar një koordinim sa më të mirë midis planit operacional të punës dhe dokumentave të tjera të planifikimit, matrica ekzistuese e sistemit Microsoft Project Management është përmirësuar duke u pasuruar me kolona të reja ku pasqyrohet informacion për shkallën e koordinimit të planit operacional të punës me kuadrin strategjik të planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë, buxhetin e Shtetit, Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve, Programin e Qeverisë, prioritetet e Keshillit të Ministrave, prioritetet e Bashkimit Evropian, prioritetet e Ministrisë. Plotësimi me cilësi të informacionit në

<sup>10</sup> Dokumentat baze të planifikimit në fillim të mandatit kanë qenë strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale afat mesme dhe afat gjata, dokumentat e planifikimit buxhetor afat shkurtërt dhe afat mesëm, (si dhe plane pune të fragmentarizuara dhe hartuar pa një metodologji të unifikuar), të cilët edhe pse kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm, nuk mund të jepnin një pamje të qartë se cila ishte ecuria dhe shkalla e realizimit të punëve në rang ministrie apo edhe Qeverie.

kete matrice eshte nje tjetër sfide per te cilën administrata eshte përpjekur dhe do te vijojte te përpiqet te punoje.

Në kuadër të **Objektivit 2: "Sistem transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis"** kanë filluar të zbatohen 5 nga 12 aktivitetet e parashikuara.

***Është arritur progres në plotësimin e mekanizmave ligjore e insitucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike.*** Përfundoi puna për plotësimin me akte nënligjore dhe sigurimin e zbatimit të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. U aprovua nga Këshilli i Ministrave kuadri ligjor për ngritjen e regjistrat elektronik "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik". Në zbatim të këtij ligji 7 strategjitë e miratuara gjatë vitit 2015 kaluan në një proces të gjerë konsultimi publik. Impakti i zbatimit të këtij ligji ka qene i menjehershëm. Konkretisht të dhënat tregojnë se në 74 projektligje të miratuara në Këshillin e Ministrave në periudhën korrik – 31 dhjetor 2015, vetëm 37 prej tyre janë objekt konsultimi mbështetur ne kriteret e përcaktuara ne ligj. Nga këto rezultojnë se janë konsultuar publikisht 36 projektligje ose 97%. Nga monitorimi rezultojnë se vetem projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920 datë 19.05.2015 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" nuk ka kaluar procedurën e kërkuar të konsultimit publik.


Gjatë proceseve të konsultimit ministrite e linjës kanë marrë 408 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 227 rekomandime ose 56% të tyre si dhe u janë paraqitur 3 ankesa. Midis mënyrave të ndryshme të konsultimit publik që ministrite e linjës kanë aplikuar rezultojnë të jenë organizuar edhe 71 takime publike. Grafikët e mëposhtëm paraqesin shkallën e zbatimit të ligjit në total dhe për të gjitha ministritë të cilat për aktet ligjore që nxjerrin duhet të ushtrojnë procedurën e konsultimit publik.

Gjithashtu në vëmendje të monitorimit ka qenë jo vetëm kryerja e procesit të monitorimit por dhe vlerësimi i cilësisë së këtij procesi. Nga vlerësimi i bërë i cilësisë së procesit të konsultimit rezultojnë se ende ministritë janë larg kryerjes së procesit të konsultimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ligji. Plotësimi i kërkesave të ligjit nga vlerësimi konsiderohet të jetë vetëm në nivelin 60%, ose 5.25 pikë<sup>11</sup> (Grafiku 6 vija jeshile). Pjesa më e madhe e ministrive renditen mbi mesataren e cilësisë, por ende ka ministri të cilat janë larg kryerjes së procesit të konsultimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ligji. Siç jepet edhe nga grafiku 6, ministri si MZHETS, MF duhet ti kushtojnë rëndësi më të madhe realizimit të procesit të konsultimit sipas kërkesave të ligjit.


### **Të dhënat mbi aktet ligjore të hartuara dhe që kanë kaluar procedurën e konsultimit publik në total dhe sipas ministrive**

<sup>11</sup> Vlerësimi i sistemit të cilësisë se procesit të konsultimit bëhet duke u bazuar në shkallën 0-8, ku 0 përcakton rastet kur asnjë nga kërkesat e ligjit nuk është respektuar nga ministrite dhe 8 = gjithë kërkesat e ligjit janë respektuar me korrektësi.

Grafiku 5: Total




Grafiku 6: Vlerësimi i cilësisë së procesit të konsultimit publik sipas ministrive



Grafiku7: Numri i ligjeve që janë aprovuar dhe kanë kaluar në konsultim publik sipas ministrive

Burimi: Ministri Shtetit për Marrëdhënie me Parlamentin, NJMLP

***Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar një proces të gjerë konsultimi publik dhe provat e përfshirjes së publikut dhe aktorëve të interesuar në proces në vitin 2015 është në nivelin 97%. Cilësia e procesit të konsultimeve vlerësohet të jetë në nivelin 5,25 pikë nga 8 pikë (vlerësimi maksimal).***



**Gjithashtu janë bërë përpjekje për të siguruar publikimin e përditësuar dhe të konsoliduar të bazës ligjore në faqet e internetit të ministrive të linjës.** Në këtë kuadër, nga procesi i monitorimit, rezulton se ministrinë e linjës kanë publikuar në faqet e tyre të internetit 1,190 akte. Nga totali i 1190 akteve të publikuara, janë monitoruar për efekt të publikimit të përditësuar dhe të konsoliduar, 945 Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave. Nga këto 945 akte, vetëm 255 akte kanë pësuar ndryshime, e për pasojë duhet të shoqërohen me publikim të përditësuar e të konsoliduar të tyre. Nga monitorimi rezulton se në 255 akte, 67 akte ose 26 % e akteve janë publikuar të përditësuar. Po kështu në 255 akte, 60 akte ose 24% e akteve janë publikuar me tekst të konsoliduar.

**Qeveria i ka kushtuar një vëmendje të veçantë përmirësimit të procesit të hartimit dhe cilësisë së legjislacionit.** Përpjekje janë bërë për të përmirësuar procesin e planifikimit të akteve që Qeveria synon të miratojë. Në këtë kuadër, Programi i Përgjithshëm Analitik i Akteve 2016 (PPAA) është hartuar në mënyrë të koordinuar me dokumenta të tjera të planifikimit sic janë Plani Operacional i Punës së ministrise për vitin 2016 si dhe Plani Kombetar i Integritimit European për vitin 2016.

Gjithashtu po punohet për të siguruar që procesi i hartimit të legjislacionit të zhvillohet në mënyrë transparente të bazuar në politika dhe i përafuar me *acquis*. Gjatë vitit 2015 është përmirësuar platforma e sistemit elektronik *e-akte*, për të mundësuar monitorim në kohë reale të procesit të hartimit të legjislacionit në ministritë e linjës dhe rakordim të këtij procesi me procese të tjera planifikuese dhe politikëbërëse. Në sistem janë implementuar një sërë raportesh monitorimi që do të mundësojnë transparencë më të madhe të proceseve të punës për hartimin e legjislacionit dhe jo vetëm, si dhe sigurimin e ndërlidhjes më Planin Kombetar të Integritimit si dhe në Programin e Qeverisë.

Gjatë vitit 2015 ka filluar vlerësimi i situatës lidhur me problemet aktuale të sistemit të hartimit të legjislacionit. Ministria e Drejtësisë ka evidentuar disa nga problematikat aktuale të sistemit të hartimit të legjislacionit. Përfundimi i vlerësimit parashikohet të bëhet në Shkurt 2016. Rezultatet e vlerësimit do të ndihmojnë në marrjen e masave të duhura për realizimin e ndërhyrjeve të mëtejshme institucionale e ligjore.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve të njësive që merren me hartimin e legjislacionit dhe të njësive qendrore monitoruese gjatë vitit 2015, janë trajnuar të 12 nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit, në Ministrinë e Drejtësisë.

**Një vëmendje e veçantë merr forcimi i procesit të zbatimit të analizave rregullatore të impaktit.** Gjatë 2015 është punuar për ndërtimin e funksionaliteteve të rrjetit të hartimit të legjislacionit. Ky rrjet për momentin përfaqësohet nga një rrjet juristësh që do të punojnë për hartimin e akteve ligjore në ministritë e linjës. Roli dhe funksioni i rrjetit të juristëve i cili është ende në proces ndërtimi, do të jetë puna për hartimin e legjislacionit si dhe realizimin e vlerësimeve "*soft RIA*". Qeveria po punon për hartimin e formulareve të vlerësimit (*soft RIA*) dhe vlerësimit të plotë të impaktit rregullator (*full RIA*). Formularët pritet të jenë gati nga mesi i vitit 2016.

Gjatë vitit 2015 duhej të fillonte procesi i monitorimit të cilësisë së akteve mbështetur në metodologjinë e parashikuar në pasaportën e indikatorit 2.a. Kjo metodologji është hartuar në respektim të kriterëve të relacionit ekzistues që shoqëron procesin e hartimit të çdo akti. Në fillim të procesit të matjes së këtij indikatorit metodologjia ju është prezantuar ministrive të linjës. Gjatë konsultimit me ministritë e linjës është evidentuar se kjo metodologji duhet të përmirësohet për të siguruar një vlerësim sa më objektiv dhe gjithëpërfshirës së cilësisë së aktit. Për këtë arsye zbatimi i saj është shtyrë deri në përfundimin e plotë të procesit të rishikimit të metodologjisë,

proces i cili është i lidhur edhe me sistemin e vlerësimit të performancës së anëtarëve të rrjetit të legjislacionit, i cili është ende në ndërtim e sipër.

Aktualisht po punohet për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e 30% të legjislacionit të rëndësishëm mbi të cilin Qeveria ka marrë përsipër të realizojë RIA në vitin 2017. Këto kriterë së bashku me paketën metodologjike të realizimit të RIA pritet të përfundojnë së shpejti.

Për të mundësuar realizimin e RIA po punohet edhe për ngritjen e një bazë të dhënash statistikore për variablat me kryesor të analizave RIA të sektoreve të ndryshme. Aktualisht Qeveria po ngre një platforme elektronike ku do të hidhen të dhëna statistikore që do të shërbejnë për analiza të ndryshme. NJMLP synon të integroje në këtë platforme edhe të dhënat për variablat kryesore të RIA të sektoreve të ndryshme. Puna për përcaktimin e variablave pritet të fillojë në vitin 2016.

Gjatë vitit 2015 në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes janë pilotuar dy RIA me mbështetjen e GIZ.

1. Vlerësimi i ndikimit rregullator të politikës dhe instrumentit ligjor (PIA-RIA) të zbatimit të Direktivës 2013/11/EU “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve” në Shqipëri.
2. Vlerësimi i ndikimit rregullator të politikës dhe instrumentit ligjor (PIA-RIA) të zbatimit të Direktivës 98/29/EC mbi Sigurimin e kredisë në eksport

Këto analiza kanë patur si qëllim të identifikojnë dhe prodhojnë argumenta të mjaftueshëm për vendimarrësit, mbi avantazhet dhe disavantazhet e alternativave të ndryshme politike e ligjore të adresimit të tyre, përmes vlerësimit të ndikimit/impaktit të mundshëm në sjelljen konsumatore, mjedisin dhe praktikën e biznesit, dhe ndikimin ekonomik e social në shoqëri.

Qeveria ka realizuar gjatë vitit 2015 dy analiza rregullatore impakti.

**Paralel me ngritjen e sistemit për aplikimin e të RIA-s po punohet edhe për ngritjen e kapacitëve.** Gjatë vitit 2015 është zhvilluar një modul i plotë trajnimi akademik në Welfare Economics si dhe po vijohet me trajnim në fushën e Statistikave, proces i cili do vazhdojë gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2015 janë monitoruar ndryshimet e legjislacionit brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i ligjit bazë apo i ndryshimit më të fundit të tij. Të dhënat e procesit të monitorimit tregojnë se në 151 ligje të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2015, 10 prej tyre ose 6,6% kanë pësuar ndryshime brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i vetë ligjit apo i ndryshimit me të fundit të tij.

***Vetëm 6.6% e akteve ligjore të miratuara kanë pësuar ndryshime brenda vitit të parë që nga miratimi.***



Në kuadër të *Objektivit 3 “Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanes dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi”* nga 4 aktivitetet që përmban ky objektivi 2 kanë filluar zbatimin. Edhe pse aktivitetet që i përkasin këtij objekti parashikoheshin të fillonin në vitin 2016, puna programuese ka filluar në vitin 2015.

***Në vitin 2015 ka filluar procesi i monitorimit të strategjive. Përqindja e raporteve monitoruese për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe publikuara në vitin 2015 është vetëm 10%.***

Qeveria ka aktualisht në funksionim dy sisteme elektronike monitorimi të cilat janë:

- Microsoft Project Management - ku monitorohet shkalla e realizimit të planeve operacionale të punës nga ana e ministrive të linjës si dhe
- E-akte - ku monitorohet procesi i hartimit të legjislacionit si dhe konsultimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2015 është punuar për zhvillimin e tre sistemeve të tjera monitorimi, të cilat janë:

- EDRMMS - Sistemi i Menaxhimit dhe Monitorimit të Korrespondencës Shkresore. Ky sistem është në fazën e fundit të kontrollit dhe shumë shpejt do të bëhet funksional në Kryeministri e më pas në të gjitha ministrinë e linjes.
- Sistemi i monitorimit të shkallës së realizimit të angazhimeve të programit të qeverisë. Ky sistem është drejt përfundimit të versionit të tij bazë. Ai do të vihet në pilotim në Kryeministri gjatë pranverës 2016.
- Sistemi i integruar i monitorimit të menaxhimit të cilësisë. Ky sistem është në fazat e tij të para të zhvillimit. Ai do të shërbejë si Business Intelligence Center ku do të integrohen të dhëna nga të katërt sistemet e përmendura më sipër si dhe do të aplikohen analiza të sofistikuar.

**Është përgatitur nga ASPA kurrikula e trajnimit për monitorimin e strategjive, bazuar në metodologjinë aktuale.** Trajnimi për monitorimin e strategjive ka filluar në Shtator 2015 (si pjesë e paketës së ASPAs për trajnimin e politikave publike). Gjatë vitit 2015 janë trajnuar 30 NC.

Nuk kanë filluar ende aktivitetet në lidhje me ngritjen e kapaciteteve në kuadër të përdorimit sistematik të vlerësimit të hapësirave korruptive të legjislacionit (corruption proofing). Ndërkohe projekti “Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar” i cili po zbatohet nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi është në proces të finalizimit të metodologjisë për “vlerësimin e hapësirave për korrupsion”, trajnimin e Eksperteve ligjore për zbatimin e metodologjisë të cilët do të angazhohen në zbatimin e metodologjisë dhe prodhimin e raporteve të strukturuar për vlerësimin e akteve ligjore. Gjithashtu do të ngrihet Databaza Elektronike për raportet e vlerësimit të akteve ligjore sipas metodologjisë së zhvilluar. Kjo do të ndihmojë me tej

edhe për vijueshmërinë e ngritjes së kapaciteteve të administrates publike për kryerjen e vleresimeve të legjislacionit për hapsira korruptive.

***Numri i përgjithshëm i raporteve të monitorimit të vëna në dispozicion të publikut nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të Qeverisë për vitin 2015 është 4.***

#### **- Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur të aktiviteteve**

- Kryeja në kohë e procedurave të tenderimit brenda vitit 2016 të kompanisë që do të zhvillojë sistemin e IPSIS. Pas ngritjes së sistemit do të përgatiten modulet e trajnimit për tu vënë në zbatim për trajnimin e stafëve në institucionet respektive.
- Zhvillimi në kohë i disa metodologjive që janë parakusht për zbatimin e aktiviteteve respektive si: (i) përfundimi i hartimit të manualit për hartimin e legjislacionit; (ii) hartimi për zhvillimin e RIA-s; (iii) përfundimi metodologjisë për “vlerësimin e hapesirave për korrupsion”, (iv) përfundimi i vlerësimit të nevojave për trajnim të strukturave që përfshihen në procesin e planifikimit strategjik dhe (v) metodologjisë për monitorimin e vlerësimin e zbatimit të strategjive.

#### **Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2016:**

- Hartimi i metodologjisë së re për monitorimin e strategjive si dhe rishikimi i bazës ligjore lidhur me sistemin e monitorimit të strategjive
- Zhvillimi i Sistemit të IPSIS
- Ngritja e sistemit të monitorimit të strategjive sektoriale, ngritja e kapaciteteve të ministrive të linjës dhe Njesisë së Planifikimit Strategjik për të realizuar sic duhet procesin e monitorimit.
- Vënia në funksion e Sistemit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Korrespondencës Shkresore në të gjithë ministrinë e linjës
- Pilotimi e më pas vënia në funksion të plotë e Sistemit të monitorimit të shkallës së realizimit të angazhimeve të programit të qeverisë.
- Përfundimi i dizenjimit të sistemit “Sistemi i integruar i monitorimit të menaxhimit të cilësisë


#### **(b) Prioriteti 2: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike**

Reformat e planifikuara në kuadër të Prioritetit të II synojnë:


- Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.
- Ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.

**Kjo fushë përbëhet nga 9 aktivitete, 6 prej të cilave kanë filluar të zbatohen dhe 3 aktivitetet e tjera do të fillojnë të zbatohen në vitin 2016, sic paraqitet në grafikun 9 më poshtë. Nuk ka pasur asnjë aktivitet të përfunduar në vitin 2015 në kuadër të këtij prioriteti (grafiku 10).**

Grafiku 8: Numri i aktiviteteve në zbatim



Grafiku 9: Statusi i realizimit të aktiviteteve



### - Progresi kundrejt aktiviteteve

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të **Objektivit 4: Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut** janë gjithsej 5 nga të cilat vetëm 2 kanë filluar të zbatohen në vitin 2015.

**Me synimin fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut**, DAP po punon për të realizuar manualin e procedurave për çdo institucion qendror. Element kryesor në këtë proces është hartimi i përshkrimeve të punës, të mirëshkruara dhe të standartizuara për çdo grup pozicionesh, pjesë e shërbimit civil. Për këtë gjatë vitit 2015 DAP ka vijuar punën për të analizuar përshkrimet e punës për secilin pozicion në shërbimin civil, pjesë e administratës shtetërore. Aktualisht ka filluar procesi i konsultimit me tre institucione qendrore, MF, MZHETTS dhe MEI me qëllim të kuptuarit e problematikave të hasura gjatë hartimit të përshkrimeve të punës. Kjo gjë është bërë nën asistencën e Projektit të Binjakëzimit IPA 2012 “Mbështetje për reformën e shërbimit civil në Shqipëri”. Në këtë kuadër është realizuar edhe seminari 2-ditor, ku krahas përfaqësuesve të këtyre institucioneve, të pranishëm kanë qënë edhe përfaqësues të institucioneve të tyre të varësisë.

Si pjesë e reformës territoriale dhe fuqizimit të bashkive të reja, fokusi ka qënë **të sigurohet mbështetja metodologjike për organizimin dhe funksionimin e njësive të reja administrative të vendit dhe forcim të kapaciteteve zbatuese**. Deri në 31 dhjetor 2015 janë hartuar 5 modele tip organizimi të bashkive, nga të cilët 1 ju është dërguar bashkive ndërsa 4 modelet e tjera do ju

dërgohen brenda tremujorit të parë 2016. Po vazhdon puna për hartimin e listës së funksioneve, sipas ligjit të ri të vetëqeverisjes vendore 139/2015. Kjo listë pritet t'i vihet bashkive në dispozicion tremujorit të parë 2016.

- *Numri i sporteleve me standard të përmirësuar të shërbimit në institucionet qendrore dhe degët e tyre në vitin 2015 arriti në 15 (sportele), nën administrimin e ADISA-s.*

- *51 është numri i shërbimeve të ofruara me standardin e përmirësuar në vitin 2015.*

Të katër aktivitetet e planifikuara në kuadër të ***Objektivit 5: Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike*** kanë filluar të zbatohen në vitin 2015 dhe është bërë progres i mirë në shumë fusha.

Gjatë tremujorit të katërt 2015 ka filluar puna për hartimin e dokumentit të politikave afatgjata për reformën e ofrimit të shërbimeve, i cili pritet të miratohet brenda tremujorit të parë 2016. Janë zhvilluar dhe takime konsultimi për elementet kryesore të tij në fillim të muajit dhjetor (3 – 4 dhjetor 2015) me përfaqësues të përfituesve: nga organizatat e shoqërisë civile dhe biznesi, si dhe me përfaqësues nga institucionet qendrore në fokus si dhe partnerët ndërkombëtarë. Pas një konsultimi të gjerë me të gjitha grupet e interesit, është miratuar nga Këshilli i Ministrave projektligji për ofrimin e shërbimeve publike në sportel ku parashikohet transformimi i ADISA-s në agjenci autonome, si dhe janë përcaktuar detyrat në drejtim të përcaktimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së standardeve në shërbimet publike, ku përfshihet dhe ndarja e sporteleve (Front Office-FO) nga zyrat përgjegjëse për dhënien e shërbimeve publike (Back Office-BO).

Në tremujorin e katërt të vitit 2015, ADISA marrë nën administrim sportelet e shërbimit në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë, duke pilotuar kështu ndarjen FO-BO e duke ndryshuar mënyrën organizimit të punës, vendosur standarde të reja në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuar përvojën e qytetarëve në marrëdhëniet me këtë institucion.

Paralel me hapat ligjore, rregullatore e institucionale po punohet për ngritjen e infrastrukturës fizike për të qendrës së ofrimit të integruar të shërbimeve publike në Tiranë. Juria ndërkombëtare e konkursit të hapur për koncept-ide mbi masterplanin e hyrjes së parkut të Tiranës, ku përfshihet dhe ajo për Qendrën e Shërbimeve Publike në Tiranë, ka shpallur studiot fituese të vendit të parë, të dytë dhe të tretë. Ndërkohë, ka hyrë në fazën e kontraktimit, me financim nga Banka Botërore, procesi i prokurimit për realizimin e një studimi fizibiliteti, në rang vendi, si për ndarjen FO-BO, ashtu dhe lidhur me përqendrimin e ofrimit të shërbimeve publike në fushën e pronës, transportit, sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, gjendjen civile, arsimit, regjistrimit dhe licencimit të biznesit në qendra me një ndalesë dhe në një vend.

Në kuadër të procesit të Krijimit të Sporteleve Unike për shërbimet administrative në nivel vendor, ka filluar pilotimi i sporteleve unike në bashkitë Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.

*5 sportele unike janë krijuara në institucionet e pushtetit vendor deri në fund të vitit 2015.*

#### - Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur të aktiviteteve

- Realizimi i studimit të fizibilitetit për ndarjen FO-BO dhe ofrimin e përqendruar të shërbimeve.
- Ristrukturimi i ADISA-s në përputhje me parashikimet e ligjit për ofrimin e shërbimeve publike në terren.

#### - Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2016

- Adoptimi i modeleve të reja të menaxhimit në të gjithë Bashkitë.
- Përgatitja e planit për shtrirjen në rang kombëtar të modelit të ofrimit të përqendruar të shërbimeve me një ndalesë dhe në njëvend.
- Hapja e qendrave të përqendruara të ofrimit të shërbimeve publike.
- Shtrirja e sporteve unike edhe në bashkitë e tjera bazuar në modelin e përzgjedhur.

### (c) Prioriteti III Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore



Reformat e parashikuara brenda këtij prioriteti synojnë:

- *Përmirësimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim*
- *Organizimin e sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme*

Sic paraqitet edhe në grafikët më lartë në kuadër të këtij prioriteti janë parashikuar të realizohen 25 aktivitete, prej të cilëve kanë filluar të zbatohen 14 dhe 10 aktivitete të tjera do të fillojnë të zbatohen në 2016. Nga 14 aktivitetet e filluara janë realizuar plotësisht 2 aktivitete dhe 10 të tjera janë realizuar pjesërisht.

*Graph 9 : Numri i aktiviteteve në zbatim*

*Graph 10: Statusi i zbatimit të aktiviteteve*



### - Progresi i arritur në zbatimin e aktiviteteve

**Objektivi 6: Kapacitete të përmirësuara për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim**" ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve të parashikuara në strategji në raport me objektivat e tjerë, 22 aktivitete nga të cilat 14 filluan të zbatohen në vitin 2015, ndërsa 8 të tjera parashikohen të fillojnë në vitin 2016.

**Hapa të rëndësishëm janë hedhur në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike.** Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, është miratuar së fundi VKM Nr. 1037, datë 16.12.2015 "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë". Procesi i përfitimit dhe përditësimin të njohurive shtesë synon aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil. Ky proces do të përfshin testimin paraprak dhe, kur është e nevojshme, trajnimin e nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre.

**Janë rritur më tej kapacitetet njërëzore të Departamentit të Administratës Publike, më synim fuqizimin e mëtejshëm të tij për të udhëhequr strategjikisht reformën në shërbimin civil.** Pas analizës funksionale të bërë në lidhje me përgjegjësitë e reja të DAP në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, por edhe në zbatimin e SNRAP 2015-2020, u vendos që organika e DAP të shtohet me 10 pozicione duke e çuar numrin e punonjësve të DAP në 53. Kjo shtesë pritet të forcojë njësinë përgjegjëse për rekrutimin në shërbimin civil (SMBINJ) si dhe fuqëzimin e sektorit përgjegjës për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e SNRAP 2015-2020.

**Progres është arritur në drejtim të forcimit të paanshmërinë dhe garantimin e një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm dhe meritokratik dhe rritjen e integritetit të nëpunësve civilë.** DAP ka punuar për ndërtimin e Bankës së Pyetjeve, që do të përdoret në procesin e rekrutimit në shërbimin civil. Kjo Bankë Pyetjesh do të integrohet në sistemin elektronik të gjenerimit dhe vlerësimit të testeve me shkrim, i cili është ngritur falë mbështetjes financiare të Bankës Botërore, në kuadrin të Projektit IPS 2.

**Treguesi: "Numri mesatar i pjesëmarrësve në një procedurë rekrutimi për rekrutim nga jashtë dhe**

***nga brenda (transferimi) në shërbimin civil”.***

Ky tregues matet nëpërmjet dy nën-treguesve, respektivisht:

**1: Numri mesatar i pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që marrin pjesë në një procedurë rekrutimi. Ky tregues për vitin 2015 ka qenë 13.1.** Ky indikator është matur duke përlogaritur numrin total të kandidatëve të kualifikuar të cilët kanë aplikuar për një pozicion ekzekutiv (niveli specialist) i cili ka qenë 10.000 për vitin 2015, ndërsa numri i pozicioneve të shpallura : 758 pozicione.

**2 Numri mesatar i pjesëmarrësve brenda shërbimit civil që marrin pjesë në një proces rekrutimi. Ky tregues për vitin 2015 ka qenë 1.3.** Numri i aplikantëve brenda shërbimit civil, në të treja kategoritë, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë është 708. Numri i pozicioneve të shpallura për të cilat ka pasur aplikime brenda sistemit të shërbimit civil, në të treja kategoritë, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë është 527.

Me qëllim fillimin e zbatimit të këtij projekti, ka nisur puna për përgatitjen e një grupi bazë pyetjesh, që do të shërbejnë për të pilotuar gjenerimin e testeve me shkrim nga Banda e Pyetjeve. Anëtar të Komisioneve të Përhershme të Përzgjedhjes, tashmë kanë nisur punën mbi riformulimin e pyetjeve të përdorura në procedurat e rekrutimit të zhvilluara gjatë vitit 2015, për t'i përshtatur me formatin që kërkon sistemit elektronik. Grupi i parë i pyetjeve pritet të jetë gati në fillim të muajit Mars, 2016. Këto pyetje do të përdoren në procedurat e rekrutimit që do të zhvillohen në muajin Prill, 2016. Përpos pyetjeve bazë, pasurimi i mëtejshëm i Bankës së pyetjeve, përgjatë vitit 2016 parashikohet të realizohet me nga DAP nën mbështetjen financiare të Këshillit të Evropës. Të gjitha këto masa synojnë të sigurojnë paanshmërinë dhe garantimin e një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm dhe meritokratik.

Me synim rritjen e integritetit të shërbimit civil po punohet gjithashtu për përfshirjen e pyetjeve të integritetit në testimet e rekrutimit në shërbimin civil. Tashmë janë gati një sërë pyetjesh 'tip' të cilat duhet të detajohen dhe përshtaten më tej e më pas të bëhen pjesë e të gjitha procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.

***Numri i ankesave lidhur me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka qenë 3 raste.***

Në kuadër të angazhimit për thjeshtimin dhe formatimin e hapave dhe proceseve që lidhen me burimet njerëzore të administratës publike, DAP është duke punuar për hartimin e Termave të Referencës, për ekspertët që do të përfshihen në këtë proces, me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian.

***Qarkullimi vjetor i stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore ka qënë në nivelin 6.8%.<sup>12</sup>*** Për vitin 2015 numri total i lirimeve në nivel drejtues ka qënë 129 dhe numri total i stafit drejtues në fillim të vitit ka qënë 1819, ose 6.8%. Synimi është që ky tregues të ketë një tendencë në rënie.

**Ka nisur puna për ngritjen e sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve publike.** Në këtë kuadër po zhvillohet, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit IPA 2012 dhe bashkëpunimit me DAP, një grup indikatorësh për monitorimin e reformës në shërbimin civil dhe publikimin periodik të tyre. Rezultatet e dala nga monitorimi i indikatorëve të përzgjedhur do të përfshihen në raportimet periodike të DAP lidhur me punën e departamentit por edhe të gjithë institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil. Indikatorët e përzgjedhur, do të jenë të aksesueshëm për publikun, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e transparencës ndaj tij.

**Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit Informatik të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ) ka avancuar me sukses duke përfshirë elemente që sigurojnë menaxhimin dhe forcimin e kontrollit të pagave.** Tashmë janë përfshirë në SMIBNJ, të gjitha strukturat/organigramat e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil. Deri në fund të vitit 2015, në Sistem janë hedhur rreth 6000 dosje personeli, ku secila prej tyre përmban të dhënat personale të të punësuarit, të tilla si: arsimi, kualifikimet, etj si dhe të dhëna në lidhje me historikun e punësimit. Një tjetër funksionalitet i rëndësishëm i SMIBNJ është përlllogaritja e pagave bazuar në skemat dhe kategorite e tyre. Ndërveprimi i SMIBNJ me Sistemin e Thesarit tashmë ka përfunduar dhe sistemet mund të shkëmbejnë informacionin e gjeneruar automatikisht lidhur me fondin e pagave dhe pagat e punonjësve. Testimi është kryer gjatë muajve Shtator-Nëntor 2015 për një numër të kufizuar të ministrive, me synimin për ta kaluar sistemin në funksion të plotë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2016. Gjithashtu, ka përfunduar trajnimi i përfaqësuesve të burimeve njerëzore dhe financës, të të gjitha institucioneve qendrore dhe varësisë së tyre, pjesë e shërbimit civil për përdorimin e Sistemit. Trajnimi do të vijojë për njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura.

**Është hartuar dhe miratuar plani i trajnimit 2016 në kuadër të Strategjisë RAP.** Plan i trajnimit është hartuar në përputhje me nevojat për trajnim të identifikuar nëpërmjet Vlerësimit të Nevojave për Trajnim të realizuar në institucionet e shërbimit civil. Plan i trajnimit përcakton, Programet e trajnimit të vazhdueshëm sipas nevojave të nivelit strategjik; Programet e trajnimit të detyrueshëm; Programin e trajnimit të thelluar; dhe Kurse specifike sipas kërkesave të institucioneve. Për vitin 2016 do të zhvillohen (vetëm me fonde të buxhetit të shtetit) 800 ditë trajnimi dhe planifikuar të trajnohen 3500 nëpunës civilë.

Në kuadër të projektit të Binjakëzimit po rishikohen kurrikulat e trajnimit që përbëjnë thelbin e modelit të trajnimit të vazhdueshëm. Këto kurrikula trajnimi do të përmbledhen në programme

<sup>12</sup> Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e stafit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore që janë larguar (ose hequr) nga pozicionet e tyre në një vit/pjesëtuar me numrin total të stafit drejtues në administratën qendrore në vitin e dhënë.



gjithëpërfshirëse që do të pilotohen në 5 institucione. Pilotimi do të fillojë në Tremujorin e II 2016. ASPA gjithashtu, ka finalizuar një pjesë të kurrikulës për Trajnimin në Nivelin Drejtues (TND) dhe do të finalizojë pjesën e mbetur brenda qershorit 2016. ***Niveli i kënaqësisë së pjesëmarrësve në kurset e trajnimit për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues është 80%***

Gjatë periudhës Shtator 2015 – Janar 2016, u pilotua moduli i parë (Politikat e BE dhe Çështjet ndërkombëtare) në dy kurse trajnimi. Zyrtarët e trajnuar ishin pjesë e kategorisë së përfituesve në grupin TND. Opinioni i marrë nga pjesëmarrësit në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë dhe trajnerët do të shërbejë për përmirësimin e kurrikulës në të ardhmen.

**Janë hedhur hapat për modernizimin e sistemit të trajnimit dhe rritjen e aksesit në kurrikulat e trajnimit nëpërmjet zhvillimit të platformës *e – learning* dhe *e – training*.** Me qëllim ngritjen e platformave dhe përdorimin e programeve të zhvillimit në këtë platformë, ASPA ka hedhur on-line dhe modulet e para, Historiku i BE dhe Institucionet e BE dhe Procesi i Stabilizim Asociimit dhe Marrëdhëniet Shqipëri-BE, të cilat janë tashmë të aksesueshme për pjesëmarrësit në trajnim. Kjo platformë do të mundësojë:

- Ofrimin e disa temave trajnimi on-line, mundësi përfitimi njohurish për një numër më të madh nëpunësish civil dhe punonjësve të tjerë të administratës publike
- Marrjen e njohurive dhe aftësive në vendin e punës pa shpërbujtje nga puna
- Uljen e kostove të trajnimit, duke konsideruar që kostot për trajnimet online janë përgjithësisht më të ulta se trajnimet tradicionale në salla
- Mundësinë për akses në arkiven e kurrikulave të ASPA nëpërmjet krijimit të e-librari

**ASPA po punon drejt krijimit të qendrës së menaxhimit të informacionit, biblioteka e saj së shpejti do të ekzistojë në formatin *e-library*.** Bërthama e pare do të jetë *e-library* e krijuar me mbështetjen e projektit DLDP që ka filluar në Tetor 2015. ASPA me mbështetjen e këtij projekti ka bërë katalogimin e kurrikulave ekzistuese për trajnimin e NJQV ku përfshihen 105 kurrrikula trajnimi.

**Funksionimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së trajnimit përmes sistemit të vlerësimit të kurseve vazhdon të mbetet në vemendje të ASPA-s.** Janë përcaktuar objektivat e kënaqësisë së klientit për të gjithë kurset e trajnimit dhe ndiqen çdo vit. Janë hartuar formularët e vlerësimit pas përfundimit të kursit si dhe formularët e vlerësimit të ndikimit të kursit nga vete pjesëmarrësit në kurs dhe nga eprorët direkt. Për vitin 2015 nga përpunimi i formularëve të vlerësimit të kursit rezultat e vlerësimit janë si më poshtë (në një shkallë 1 deri në 6)

1. Vlerësimi mesatar i kurseve të trajnimit 5.5
2. Vlerësimi i organizimit të kurseve 5.37
3. Vlerësimi i metodologjisë 5.76

Një nga treguesit cilësor të matjes së arritjeve të ASPA është treguesi i Kënaqësisë së Klientit (*customer satisfaction*). Ky indikator është mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar pas një periudhe kohore se sa, programet e trajnimit, të ofruara nga ASPA, janë efektive, në përshtatje me nevojat reale dhe kanë ndihmuar në rritjen e performancës së administratës publike.

Ky tregues shërben në përmirësimin e kurrikulave të trajnimit, mundësinë e ofrimit të metodologjive inovative në zhvillimin e trajnimit si dhe ruajtjen dhe rritjen e imazhit të ASPA si një qendër për zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale.


**Kutia 2: Metodatat e Matjes së Përformancës**

Përcaktimi i kënaqësisë së klientit (në këtë rast administratës publike) do të përcaktohet nëpërmjet:

- Përdorimit të formularëve të matjes së reagimit të pjesëmarrësve pas trajnimit;
- Përdorimit të formularëve të matjes së ndikimit të trajnimit pas një periudhe 6 – 12 mujore (*formularë të vetvlerësimit*);
- Përdorimit të formularëve të matjes së ndikimit të trajnimit pas një periudhe 6 – 12 mujore (*formularë për eprorin direkt*);
- Studimit dhe përpunimit të formularëve të vlerësimit të arritjeve individuale (*pjesës së trajnimit*) në punë të nëpunësit civil (çdo vit);
- Marrjes së informacionit nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të çdo institucioni;

**Ndërkohë në vitin 2015 ka rifilluar procesi i mbykqyrjes së zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”.** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KSHMC) ka zhvilluar aktivitetin e tij për një periudhë rreth një vjecare që pas miratimit të strukturës me Vendimin Nr. 98, datë 4 dhjetor 2014, të Kuvendit të Shqipërisë. Në mënyrë që ky proces të zhvillohej në mënyrë sa më transparente, profesionale dhe efektive me ndihmën e asistencës teknike të ekspertëve të SIGMA-s, janë standardizuar procedurat dhe metodologjia e mbikëqyrjes<sup>13</sup> të institucioneve të administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me Nenin 11, të Ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Hyrja në fuqi e ligjit të ri për nëpunësin civil e zgjeroi në mënyrë të ndjeshme fushën e shërbimit civil, e për pasojë u rrit numri i pozicioneve të punës që u bënë pjesë e tij. KMSHC gjatë gjithë vitit 2015, duke marrë parasysh vështirësitë për shkak të tipologjisë së ndryshme të institucioneve që përfshihen në fushën e shërbimit civil realizoi vlerësimin e situatës në të cilën ndodhet shërbimi civil.



<sup>13</sup> Në fillim të vitit 2015 janë miratuar dy aktet bazë të funksionimit të Institucionit: Rregullorja e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, miratuar me Vendimin Nr. 18, datë 11.03.2015 dhe Rregullorja “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar parimet bazë dhe rregullat procedurale që do të udhëheqin institucionin e Komisionerit gjatë ushtrimit të kompetencave që i ka ngarkuar ligji.

Gjatë vitit 2015 u kryen 74 procese mbikëqyrje dhe inspektimi në institucione që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, (ndër të cilat 1 institucion të pavarur, 11 institucione të administratës shtetërore dhe 62 njësi të qeverisjes vendore, që në total përfshijnë mbi 2.000 pozicione pune pjesë e shërbimit civil). Në përfundim të procesit Komisioneri ka paraqitur rekomandimet përkatëse për rregullimet përkatëse ligjore që duhet të ndërmerreshin nga institucionet e mbikëqyrura:

- Në 28 raste është kërkuar të bëhet revokimi i akteve administrative për emërimet kryera në kundërshtim me ligjin dhe shpallja e këtyre pozicioneve si pozicione të lira.
- Në 24 raste revokimi, ndryshimi apo nxjerrja e akteve administrative për deklarimin e statusit të punësimit;
- Në 7 raste të nxirren aktet e transferimit/riemërimit
- Marrjen e mendimit me shkrim të nëpunësve të transferuar dhe administrimi i pëlqimit me shkrim në dosjen individuale në rastet e transferimit për shkak ristrukturimi.
- Hartimin dhe miratimin e përskrimeve të punës në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar.

Gjatë proceseve të hetimeve administrative KSHMC ka konstatuar këto probleme në lidhje me administrimin e shërbimit civil:

- Mospërmbyllja e procesit të deklarimit të statusit të punësimit, me një akt administrativ që të përcaktojë statusin e tij në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, megjithëse të gjithë punonësit ishin trajtuar si nëpunës civilë, apo nëpunës civilë në periudhë prove, gjatë administrimit të shërbimit civil në institucion. Parregullsia në këtë rast është e karakterit formal, që në fakt deri në momentin e mbikëqyrjes nuk kishte sjellë pasoja negative në dëm të nëpunësve civilë;
- mangësi në procesin e hartimit të përskrimeve të punës dhe mos administrimi i tyre pranë Departamentit të Administratës Publike.;
- mospërfundimin në kohë të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë;
- mangësi në dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja e personelit;
- probleme formale në lidhje me procedurën e ecurisë disiplinore.

Tabela *Mënyra e përfundimit të inspektimeve*

| <i>Mënyra e përfundimit</i> | <i>Kryer hetim administrati v dhe konstatuar parregullsi</i> | <i>Kryer hetim administrati v dhe konstatuar veprime të rregullta</i> | <i>Kthyer përgjigje në rrugë administrativ e</i> | <i>Pezulluar për arsye ligjore</i> | <i>Pushuar për shkak të ankimit në gjykatë</i> | <i>Ankesa të bashkuara dhe të zgjidhura në kuadër të mbikëqyrjes</i> | <i>Mbartur nga 2015 në 2016</i> |
|-----------------------------|--|---|--|------------------------------------|--|--|---------------------------------|
| 97                          | 22   | 14  | 8  | 19                                 | 9  | 22   | 3                               |
| <i>Në %</i>                 | <i>23%</i>   | <i>14%</i>  | <i>8%</i>  | <i>20%</i>                         | <i>9%</i>                                      | <i>23%</i>   | <i>3%</i>                       |

Në rastet kur janë konstatuar mangësi apo të meta në zbatimin e ligjit, është zbatimi i detyrimit e tyre ligjore, duke revokuar apo korrigjuar aktet e nxjerra prej tyre.

Një nga objektivat më të rëndësishme të reformës së shërbimit civil dhe vetë Strategjisë është ai i *Organizimit të sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme (Objektivi 7).*

Në kuadër të këtij objektivi janë parashikuar të realizohet një dokument për politikën në sistemin e pagave dhe miratimi i strukturës së re të pagave dhe niveleve, si dhe rishikimi i raporteve mes pagës maksimale dhe pagës minimale/mesatare në administratën publike, me qëllim ruajtjen e një piramide objektive të pagave dhe motivimin e pozicioneve drejtuese, si edhe diversifikimi i klasifikimit sipas përmbajtjes së punës. Të tre këto aktivitete parashikojnë të fillojnë në vitin 2016 dhe të përfundojnë në vitin 2017.

Të dy treguesit që lidhen me politikën e pagave nuk kanë pësuar ndryshime në vitin 2015:

*Raportit ndërmjet pagës maksimale dhe pagës minimalë në vitin 2015 mbetet në nivelin 11.7%.*

*Ndryshime të skemës dhe numrit të pozicioneve në skemën e pagave mbështetur në përmbajtjen e përshkrimit të punës = 0*

Të dy treguesit e mësipërm lidhen me realizimet e tre aktiviteteve të renditura më lartë.

#### **- Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur**

Për zbatimin në kohën e duhur rekomandohen hapat e ardhshëm:

- Vlerësimi nga DAP i analizës së ndërtimit në pikëpamje organizative dhe numerike të njësisive të menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe vlerësimi e njohurive të punonjësve ekzistues në këto struktura, në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil.
- Përfundimi në kohë Bankës së Pyetjeve dhe zbatimi efektiv në procedurat e rekrutimit që do të zhvillohen pas muajit Prill 2016.

#### **- Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2016**

- Përfundimi i sistemit të monitorimit të reformës në shërbimin civil dhe hartimi e publikimi i raportit në faqen e Departamentit.
- Popullimi i HRMIS brenda vitit 2016 me të dhënat e punonjësve, dosjet e personelit për 25% të institucioneve të varesise të kryeministrise dhe ministrive të linjes.
- Vijimi i trajnimit të nëpunësve civile sipas afateve të miratuara dhe të evidentuara në Planin e Trajnimit të ASPA
- Përfundimi i rishikimit të kurrikules së ASPA-s si pjesë e procesit të marrjes së statusit të qendrës së ekselencës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

**(d) Prioriteti IV - Procedurat administrative dhe mbikëqyrja**

Reformat e parashikuara nën fushën prioritare **“Procedurat administrative dhe mbikëqyrja”** do të orientohen drejt arritjes së këtyre objektivave të mëposhtme:

- *Zbatimin e procedurave të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin*
- *Zhvillimin e një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit*
- *Rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë*
- *Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.*
- 



Kjo shtyllë përmban 12 aktivitete nga të cilat 10 kanë filluar zbatimin. Krahasuar me prioritet e tjera, ky prioritet ka shkallën më të lartë të aktiviteteve që janë duke u zbatuar krahasuar me tre shtyllat e tjera prioritare. Arritja kryesore për vitin 2015 nën këtë prioritet është në Objektivin 9 *“Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit”* ku janë realizuar gjatë vitit 2015 dy aktivitete të rëndësishme: *Studimi për vlerësimin e situatës së regjistrave themeltarë<sup>14</sup>* dhe *Krijimi i një mekanizmi për marrjen e mendimit nga qytetarët për cilësinë e shërbimeve nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me SMS të përfituesit të shërbimit<sup>15</sup>*.

Graph 11 : Numri aktiviteteve në zbatim

Graph 12: Shkalla e realizimit të aktiviteteve

<sup>14</sup> Aktiviteti 9.1.1

<sup>15</sup> Aktiviteti 9.3.1



### - Progresi kundrejt aktiviteteve

Në kuadër të **Objektivit 8: "Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin"** janë parashikuar gjithsej 7 aktivitete nga të cilat vetëm 1 aktivitet lidhur me organizimin e një studimi për mundësitë e ofrimit të shërbimeve nga njësi jashtë administratës publike nuk ka filluar të zbatohet në vitin 2015. Ky studim është në fazën e kontraktimit, me financim nga Banka Botërore.

**Qeveria ka punuar intensivisht për thjeshtëzimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve publike me qëllim uljen e kohës së ofrimit të shërbimit dhe të barrës burokratike për qytetarët dhe biznesin si dhe shmangien e korrupsionit.**

Për gati 400 shërbime administrative parësore nga institucione publike qendrore që parashikohen të ri-inxhinerohen janë përgatitur udhëzues të detajuar që përmbajnë informacion të plotë mbi procedurat, bazën ligjore dhe atë IT për këto shërbime, ashtu si dhe hartëzimet e proceseve të dhënies së tyre. Për realizimin e procesit të ri-inxhinerimit, i cili pritet të përfundojë brenda tremujorit të tretë të vitit 2016, është kontraktuar dhe një kompani konsulence ndërkombëtare.

Është kryer për mbi 1.400 shërbime të 134 institucioneve publike qendrore klasifikimi dhe kodifikimi sipas sipas një metodologjie të bazuar në praktikën më të mira të BE-së. Është krijuar dhe formulari i standardizuar i aplikimit, i cili është përshtatur për mbi 280 shërbime të 15 institucioneve qendrore. Në korrik 2015, MIAP ka nxjerrë urdhrin nr. 3477 “Për metodologjinë e klasifikimit, kodifikimit dhe formularët e aplikimit të shërbimeve që ofrohen nga administrata shtetërore”. Ndërkohë, në ligjin e ri “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” është përfshirë kompetenca për rregullat në hartimin e modeleve të shërbimeve publike dhe të kodifikimit të tyre. Ky do të jetë ligji i parë kuadër mbi ofrimin e shërbimeve, i cili do të ndikojë mbi të gjithë institucionet e administratës publike si dhe në degët e tyre lokale me synimin e unifikimit të të gjithë sistemit të ofrimit të shërbimeve. Ai parashikon dhe një qasje bashkëpunuese për shtrirjen e standardeve dhe për shërbimet e qeverisjes vendore.

**Kutia 3: Objektivat e Projektligjit "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"**

Ligji i ri synon heqjen e barrierave të tepërta administrative, rritjen e efikasitetit, transparencës, cilësisë së shërbimit, ofrim shërbimesh me disa kanale (qendra me një ndalesë, qendrave për komunikime telefonike (call center), online, ndarja midis Sporteleve të Shërbimit dhe Zyrave Përgjegjëse për Shërbimin etj.).

Objektivat e Ligjit janë:

(i) Njëhësimi dhe standardizimi i sporteleve të shërbimit të administratës nga ADISA (ndarja e Sporteleve të Shërbimit nga Zyrat Përgjegjëse për Shërbimin).

(ii) Ngritja e kuadrit të nevojshëm institucional për krijimin e modeleve të njëhësuar të ofrimit të shërbimit publik, ballë për ballë, elektronikisht si dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimit

(iii) Vendosja e rregullave për bashkëpunimin midis Sporteleve të Shërbimit dhe Zyrave Përgjegjëse për Shërbimin, duke vendosur modelet për administrimin e proceseve, si dhe të institucioneve përgjegjëse për ofrimin e shërbimit.

(iv) Ofrimi i instrumentave të nevojshëm për sigurimin e cilësisë dhe reduktimin e kohës, nëpërmjet zbatimit të parimeve të administratës së hapur, ligjshmërisë, aksesit, efikasitetit, cilësisë dhe bashkëpunimit.

Në kuadër të ri-organizimit të shërbimeve publike janë miratuar dy rregullore, përkatësisht: (i) Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës për Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara; (ii) Rregullorja e brendshme për funksionimin e sporteleve pritëse për qytetarët në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Është miratuar dhe manuali i procedurave të bashkëpunimit ADISA-ZRPP Tiranë.

Një hap i mëtejshëm është hedhur në garantimin e vlerës ligjore të kopjeve në leter të dokumentave në formën elektronike (*e-dokumentave*) nëpërmjet miratimit të ligjit Nr. 101/2015, datë 23.9.2015 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”. Gjithashtu ka përfunduar hartimi i projekt udhëzimit "Për vërtetimin e kopjes në leter të dokumentit elektronik nëpërmjet vendosjes së një, apo më shumë kodeve dy dimensionale nga institucionet publike" dhe pritet së shpejti miratimi i tij.

**Zhvillimi i Infrastrukturës së TIK po konsiderohet një element rëndësishëm jo vetëm për të rritur efikasitetin e punës së administratës publike por gjithashtu për të përmirësuar transmetimin dhe rrjedhjen e informacionit.** Në këtë kuadër, është prezantuar projekti për menxhimin e dokumentit elektronik në administratën publike (EDRMS)<sup>16</sup> duke përcjellë një

<sup>16</sup> Electronic Records and Document Management System



vizion të qartë për rritjen e eficences dhe efektivitetit brënda qeverisë shqiptare. Kjo platformë ndikon drejtpërdrejt në uljen e barrierave administrative rrjedhimisht ndikon në një performacë të lartë të veprimtarisë të administratës publike. Projekti i ERDMS është pilotuar për herë të parë në Kryeministri, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë si dhe Ministrinë e Transportit.

*Synimi i Krijimit në vitin 2017 të 2 sistemeve të reja IT për ofrimin e shërbimeve dhe ofrimi i 100 shërbimeve në formë elektronike gjatë vitit 2015 është realizuar përkatësisht: (i) 1 sistem IT- i pilotuar - projekti ERDMS në 4 institucione qendrore dhe 129 shërbime të reja të ofruara në formë elektronike në portalin qeveritar e-albania,*


**Vemendje e vecantë po i kushtohet krijimit të mekanizmave që sigurojnë përfshirjen direkte të qytetarëve në monitorimin e cilësisë së shërbimit.** Gjatë 2015 ka funksionuar mbledhja e reagimeve nga qytetarët përmes sms-ve për ofrimin e shërbimeve (Citizen Feedback Mechanism)<sup>17</sup>.

Sistemi i monitorimit është zbatuar gjatë vitit 2015 në ZRPP Tiranë, Durrës dhe Vlorë dhe në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë. Numri i qytetarëve të cilëve iu kërkua nese i ishte kerkuar ose nese kishin dhene rryshfet ne forma apo menyra te ndryshme, menjëherë pas marrjes së shërbimit deri ne fund te dhjetorit 2015 është 109412 persona. Nga këta, 30,307, ose shprehur ndryshe 30.8% e tyre, kthyen përgjigje direkte, shpesh te shoqeruar me komente mbi cilësinë e shërbimit apo problematikat e hasura gjatë marrjes së tij. Nga qytetarët përfitues, rezultoi se 16.9% e atyre që kthyen përgjigje shprehen së gjatë marrjes së shërbimit nuk ndeshën me praktika korruptive te ndonje forme. Krahas kesaj përgjigjeje, qytetare te ndryshem paten mundesi te shprehnin opinionin e tyre ne lidhje me cilesine e shërbimit, nga ku mund te evidentohet perafersisht shkalla e kënaqësisë së qytetarëve përfitues në masën 11.04% (0.4% e vlerësojnë cilësinë e dhënies së shërbimit dhe 11% shprehen se janë të kënaqur nga shërbimi).



<sup>17</sup> Informacion më ilustrues gjendet në adresën: <https://ë.youtube.com/tch?v=pJCyeMUzMVQ>



Grafiku 13: *Niveli (%) Reagimit te Qytetareve ne lidhje me praktikat korruptive ne zyrat pritesese te ZRPP dhe QSUT.*

Burimi: *stopkorrupsioni.al*

Puna për realizimin e një sondazhi bazë mbi nivelin e kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve pritet të fillojë në muajin mars, për shkak të zgjatjes së afateve të prokurimit dhe kontraktimit përmes financimit nga Banka Botërore.

**Kuadri strategjik e ligjor që siguron dhe mbështet ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë është i përgatitur tashmë dhe po vjen duke u zhvilluar më tej.** Konkretisht Strategjia Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020 vendos si vizion të saj, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike online si tregues i rritjes së transparencës së qeverisjes shqiptare. Nga ana tjetër prioriteti strategjik i Agjendës Digjitale mbetet shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike<sup>18</sup>, e-shërbimeve për qytetarët dhe biznesin. Një sërë aktesh ligjore të nxjerra plotësojnë kuadrin ligjor të nevojshëm<sup>19</sup>.

Një sërë shërbimesh ofrohen tashmë në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit unik *e-Albania*. Në maj të vitit 2015 u ri-dizenjua plotësisht portalin unik qeveritar *e-Albania*. Portal i cili vjen në formë më të thjeshtë, më të lehtë dhe më praktike gjithashtu i përshtatur për celularë, për android dhe aplikime IOS, ku qytetarët shqiptarë, bizneset dhe zyrtarët qeveritar aktualisht përfitojnë mbi **765** shërbime elektronike. Nga të cilat **248** shërbime elektronike **të nivelit 3 dhe 4** dhe mbi **540 shërbime elektronike të nivelit 1 dhe 2** sipas standartit UNPAN.

**Portali i ri, ofron për herë të parë shërbimin e pagesave on-line.** Aktualisht qytetarët shqiptarë, bizneset nëpërmjet kartës së kreditit ose debitit, mund të përfitojnë nga disa shërbime si të paguajnë faturat e energjisë elektrike dhe ujit, taksat e makinave, gjobat për shkeljet e trafikut etj. Synimet për vitin 2016 mbeten mjaft ambicioze përsa i përket shtimit të shërbimeve

<sup>18</sup> Axhenda Dixhitale 2015-2020 faqja 27

<sup>19</sup> VKM nr 703 datë 29.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”; Ligji nr 10325 datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”; Ligji nr 107 datë 1.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”; Ligji nr 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”; VKM nr 734 datë 28.08.2013 “Për krijimin e sistemit unik të rregjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike”; Specifikimet teknike “Sistemi i Ndërveprimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore; Specifikime Teknike “ESB – Government Gateëay dhe Government Payment Gateëay”; Buletini Korniza Kombëtare e Ndërveprimit.

elektronike (e-services) në portalin qeveritar E-Albania. Përgjatë 2016 është parashikuar shtimi i 150 shërbime të reja elektronike niveli 3 dhe 4.

Figura 1: Portali i Shërbimeve të integruara online - e Albania

**Në kudër të iniciativave të ndërmarra në portalin unik qeveritar, është ridimensionuar totalisht mënyra e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit dhe biznesit.** 2 vjet më parë vetëm 14 shërbime elektronike ofroheshin në portalin unik qeveritar e-Albania. Për më tepër ndërhyret e kryera nga AKSHI me qëllim lehtësimin e përdorimit të portalit unik qeveritar e-Albania për shtetasit shqiptar, bizneset dhe nëpunësit publikë, ka rezultuar në rritjen e përdorimit të këtij portalit në një mënyrë të qëndrueshme. Në këtë aspekt vetëm përgjatë vitit 2015 disa nga të dhënat që mbështesin përdorimin e gjerë të portalit jepen në kutinë 2.

***Kutia 1: Të dhëna mbi përdorimin e portalit e-Albania***

- Numri i përdoruesve të regjistruar në portalin unik qeveritar e -Albania në vitin 2015 është **76,776 regjistrime**.
- Numri mesatar i përdoruesve të regjistruar në një ditë normale është rreth **210 përdorues**.
- Nga fillimi vitit 2013 deri në 31.12.2015 numri i të regjistruarve në portal është në total **169.918 të regjistruar**.
- 765 shërbime elektronike të ofruara: (i) **248** shërbime elektronike **të nivelit 3 dhe 4** dhe (ii) mbi **540 shërbime elektronike të nivelit 1 dhe 2** sipas standartit UNPAN.

Gjatë vitit 2015 u ndërmor një tjetër iniciativë për të lehtësuar aksesin e qytetareve dhe bizneseve në shërbimet elektronike të ofruar nga portali unik qeveritar e- Albania. Në këtë kuader është realizuar projekti për vendosjen e 15 kioskave dixhitale në Qendrat Tregtare, aeroport, zyrat postare, Bashkinë e Tiranës etj.

Në kuadër të **Objektivit 10: Rritja e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë** janë parashikuar gjithsej 4 aktivitete, nga të cilat 2 kanë filluar të zbatohen gjatë vitit 2015 dhe që lidhen me zbatimin e kodit të procedurave administrative dhe sistemit të integritetit të zyrtarëve publikë.

**Kodi i Ri i Procedurave Administrative është një hap pozitiv në drejtim të arritjes së efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë.** Ligji sjell një qasje re, ndaj dhe rëndësi të vecantë në këtë kuadër merr edhe trajnimi i punonjësve publik në mënyrë që të njihen me procedurat e reja që sjell zbatimi i Kodit. Trajnimi do të nis në vijim të miratimit të Manualit të Kodit dhe akteve-nënligjore në zbatim të tij. Departamenti i Administratës Publike, ka nisur një sërë aktiviteteve me synim rritjen e sensibilizimit mbi risitë që do të sjellë Kodi i Ri dhe familjarizimin e gjerë me të. Ndër to, theksohet trajnimin me temë “Heshtja Administrative” ku marrë pjesë përfaqësues nga të gjithë ministratë e linjës.

Politika e qeverisë në këtë fushë synon gjithashtu rritjen e përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë në kryerjen e funksioneve të tyre. Ky proces synon ndër të tjera delegimin e vendim-marrjes sa

më pranë pozicionit përgjegjës për funksionin dhe shmangien e mbingarkimit të “titullarit të institucionit” nga vendimet operative.


Me fillimin e aplikimit të Kodit të Ri të Procedurave Administrative, dhe hartimin e kuadrit metodologjik e ligjor të nevojshëm për implementimin e tij, do të nis puna edhe për fillimin e procesit të delegimit. Me qëllim që ti paraprijë këtij procesi sidhe për të rritur informimin mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative, DAP më mbështetjen e projektit të Binjakëzimit IPA 2012 të financuar nga BE, ka ndërmarrë një sërë masash të cilat përfshijne edhe organizimin e sesioneve informuese më struktura të ndryshme.

Gjatë vitit 2015 nuk ka pasur ndonjë progres të vecantë në zbatimin e aktiviteteve që lidhen më forcimin e rregjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publike, rasteve të konfliktit të interesave, si dhe mbrojtjes të të drejtave të sinjalizuesve për rastet e deklarimit të veprimeve auzive apo korrupsionit, pasi ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është ende në proceduar parlamentare.

Me miratimin e ligjit për të Drejtën e Informimit në rëndesi e vecante i është kushtuar edhe objektivit *të rritjes së kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion*. Në mënyrë të vazhdueshme është bërë monitorimi i Autoriteteve publike nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit për të siguruar hartimin dhe publikimin në kohë të Programeve të transparencës, caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. **Hartimi dhe publikimi i programeve të transparencës mbetet në nivele të ulta, ndërkohë që është tejkaluar afati i përcaktuar me ligj**. Në kuadër të masave për bërjen publikë të programeve të transparencës nga institucionet publike ka filluar procesi i hartimit dhe bërjes publike të programit të transparencës. Ligji që ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2014, përcaktonte që të gjithë institucionet duhet të hartonin dhe publikonin brenda 6 muajve programet e transparencës. Rreth 1 vit nga hyrja në fuqi e ligjit, deri në fund të vitit 2015, vetëm 25% e institucioneve publike kanë bërë publike programin e transparencës. Institucionet e pavararua është dhe grupi ku këto programe janë publikuar në masën më të madhe 85% ( 17 nga 20 institucione ne total), ndërsa në nivelin më të ulët shfaqet sistemi gjyqësor me vetëm 5 % të institucioneve që kanë zbatuar kërkesën e ligjit. ( shih grafikun 14 më poshtë).

Nga Autoritet Publike janë caktuar **198** koordinatorë për të drejtën e informimit.

Grafiku 14. Të dhëna mbi hartimin e publikimin e programeve të transparencës



Ngritja e strukturave përkatëse dhe informimi e ndërgjegjësimi i publikut ta bërë që qytetarët të depozitojnë ankesat e tyre pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, në rastet kur ata gjykojnë që kjo e drejtë ju është shkelur. Bazuar në këto ankesa KDI ka ndërmarrë inspektimet e duhura të cilat janë shoqëruar edhe me sanksione në rastet kur është konstatuar shkelje e pajustificuar e ligjit.

***Numri i ankesave të depozituara pranë Komisionerit Për të Drejtën e Informimit në vitin 2015 të vlerësuara në favor të qytetarit<sup>20</sup> 247 ankesa.***

Gjate vitit 2015 janë realizuar 102 inspektime pranë Autoriteteve Publike me synim verifikimin e ankesave të depozituara.


***Indeksi i sanksioneve të vëna gjatë vitit 2015 kundrejt inspektimeve është në masën 0.2***

**Ende mbetet shqetësim reagimi në kohë nga ana e institucioneve publike ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit.** Avokati i Popullit ka vazhduar punën e tij në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Sfidat më të cilat ai ndeshët është mungesa e bashkëpunimit nga ana e institucioneve publike për realizimin e rekomandimeve të nxjerra prej tij. Të dhënat e mëposhtëme tregojnë për një tendencë gjithësesi në rritje të numrit të rekomandimeve të zbatuara nga institucionet publike, nga 43% në vitin 2014 në 66.25 në vitin 2015, si dhe një rënie shumë të lehtë të rasteve kur për rekomandimet e nxjerra Avokati i Popullit nuk merr përgjigje nga institucionet përkatëse ( rënie me 0.52%).

**Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbikëqyrëse të institucioneve të pushtetit qendror në dy vitet e kaluara jepet në grafikun e mëposhtëm.**

<sup>20</sup> Numri i Ankesave të cilësuar si të drejta është llogaritur duke zbritur nga numri total i ankesave (274) numrin e ankesave jashtë objektivit të ligjit 119/2014 (19), numrin e ankesave të paplota (5) dhe numrin e ankesave jashtë afatit.

Grafiku 15: Të dhënat e monitorimit të reagimit të institucioneve publike



Shqetësim mbetet rritja e % të kërkesave për sqarim të rasteve të vecanta për të cilat nuk ka asnjë reagim nga ana e institucioneve publike ( nga 6% në vitin 2014 në 7.38% ne vitin 2015)

#### - Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur

- Miratimi i projekt-ligjit "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"
- Realizimi në kohë i procesit të prokurimit të studimit të fizibilitetit sipas procedurave të Bankës Botërore për ndarjen e sporteleve pritëse (Front office) nga zyrat përgjegjëse për dhënien e shërbimit (Back office).

#### - Aktivitetet prioritare për vititin 2016

- Realizimi i 13 projekteve për digjitalizmin e rregjistrave themeltar, interoperabilitetin dhe ngritjen e sistemeve të reja;
- Nxjerrja e akteve nën-ligjore në kuadër të ligjit "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë" është përfshirë kompetenca për rregullat për hartimin e modeleve të shërbimeve publike dhe të kodifikimit të tyre.
- Përfundimi i procesit të hartimit dhe publikimit të programeve të transparencës në gjithë institucionet publike
- Miratimi i Manualit dhe Akteve nenligjore ne zbatim te Kodit te Procedurave.
- Miratimi në parlament i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve

## Article V. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2016

SNRAP në vitin e parë është përballur edhe më disa sfida ku kryesorja është mungesa e burimeve të plota financiare për zbatimin e saj. Përcaktimi i nevojave të financimit të SNRAP u realizua nëpërmjet procesit të vlerësimit të kostos potenciale të nevojshme, nga secili institucion i cili ka përgjegjësinë kryesore në realizimin e aktiviteteve të parashikuara.

Fondet e vlerësuara të nevojshme për zbatimin e veprimeve të SNRAP gjatë periudhës kohore prej 2015 - 2020 parashikohet të jëtë në nivelin 10.79 miliard leke ose 77 milion Euro, duke rezultuar më një boshllëk financiar prej rreth 28% të totalit të financimeve.

Me qëllim përballimin e nevojave Qeveria vendosi në dispozicion të zbatimit të strategjisë burime të brendshme financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm. Pavaresisht financimeve të parashikuara vlera e financimit ende mbetet e konsiderueshme.

Për këtë qëllim me kërkesë të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administratës Publike u realizua me asistencën e SIGMAs rishikimi i planit financiar për zbatimin e strategjisë me qëllim reduktimit të kostos të disa aktiviteteve dhe evidentimit të boshllëkut të mbetur financiar të strategjisë. Nga rishikimi i kostove u bë e mundur që të ulet boshllëku financiar në një masë të konsiderueshme. Një pjesë e institucioneve si DAP, realizuan zbatimin e një sërë aktiviteteve me kapacitetet e tyre administrative duke siguruar në këtë mënyrë një ulje të kostove shtesë për realizimin e saj, e relativisht ulje të boshllëkut financiar. Mbulimi i nevojave me financime do të jetë një çështje që do të jetë një prioritet i rëndësishëm gjatë vitit 2016.

Gjetja e burimeve financiare në kohë do të jetë edhe një parakusht për realizimin me sukses të aktiviteteve të parashikuara në kuadër të strategjisë, në mënyrë që të sigurohet realizimi në kohë i 22, ose 42% e gjithë aktiviteteve të planifikuara dhe 35 produkteve apo 44% të totalit të parashikuar në planin e veprimit.

Një sfidë tjetër me të cilat është përballur realizimi i aktiviteteve në disa sektorë është dhe mungësa e kapaciteteve njerëzore, sidomos në disa njësi të rëndësishme që merren më monitorimin e koordinimin e programeve strategjike e operacionale.

Se fundi, edhe pse janë bërë përpjekje pozitive, kapacitetet dhe eksperiencia në monitorimin e vetë strategjisë mbetet një sfidë që duhet të adresohet, si nga pikpamja e mbledhjes së të dhënave statistikore për disa fusha edhe zbatimi në mënyrë të disiplinuar dhe sistematik të proceseve të monitorimit.